

Vendim nr. 230 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **PARTIA “BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT”,**
përfaqësuar nga kryetari, Vangjel Dule.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 5, datë 09.09.2024 të Kolegjit Zgjedhor**
Gjyqësor; nr. 19, datë 26.08.2024 të Komisionit për Ankimimet
dhe Sanksionet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
Konstatimi i pavlefshmërisë së zgjedhjeve vendore për kryetar të
Bashkisë Himarë, të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit
(gjithsej 36 QV-të) të zonës zgjedhore Bashkia Himarë në datën
04.08.2024.

BAZA LIGJORE: **Nenet 1, pika 3, 2, pika 2, 3, 4, 6, pika 1, 15, 17, 18, 42, pika 2, 44,**
45, 131, pika 1, shkronjat “a”, “c” dhe “f” dhe 134, pika 1,
shkronjat “gj” dhe “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(Kushtetuta); neni 3 i Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane
për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 2, 25 dhe 26 të Paktit
Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të ratifikuar me
ligjin nr. 7510, datë 08.08.1991; nenet 27, 71/a etj. të ligjit nr. 8577,
datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 14.05.2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Shtetasi Dhionisios Alfred Beleri ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë së Himarës, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë”. Me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 88 e ka shpallur këtë kandidat fitues dhe me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka dhënë atij mandatin e kryetarit të Bashkisë së Himarës, qarku Vlorë.

2. Ndërkohë, për shkak se dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve (më 12.05.2023) shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal, ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg” me vendim të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO), Tiranë i cili është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Për rrjedhojë, ai shtetas nuk ka bërë betimin si kryetar i Bashkisë së Himarës dhe gjykatat e zakonshme, sikundër drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, kanë rrëzuar edhe kërkesat e tij për marrjen e lejes së veçantë për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak të Himarës.

3. Në vijim, ky shtetas është deklaruar fajtor dhe dënuar nga GJKKO-ja e shkallës së parë për veprën penale për të cilën akuzohej, vendim që është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit. Për këtë shkak KQZ-ja ka shpallur pavlefshmërinë e mandatit të fituar nga shtetasi Dhionisios Alfred Beleri si kryetar i Bashkisë së Himarës. Në këto kushte, Këshilli i Ministrave ka njoftuar zyrtarisht Presidentin e Republikës për vakancën e krijuar në Bashkinë e Himarës dhe për caktimin e datës së zgjedhjeve, brenda afateve që përcakton Kodi Zgjedhor (KZ). Me dekretin nr. 244, datë 05.07.2024, Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës, ka caktuar datën 04.08.2024 për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë së Himarës, qarku

Vlorë. Me vendimin nr. 124, datë 05.07.2024, KQZ-ja ka regjistruar koalicionin “Bashkë fitojmë”, të kryesuar nga Partia Demokratike, si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje, pjesë e të cilit ka qenë edhe partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).

4. Në përfundim të procesit zgjedhor, me vendimin nr. 85, datë 05.08.2024, KZAZ-ja ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë së Himarës dhe ka shpallur fitues kandidatin e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Ky vendim është kundërshtuar në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë”, me kërkesën ankimore të datës 09.08.2024, të depozituar edhe nga kryetari i PBDNJ-së, duke u kërkuar edhe pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit (gjithsej 36) të asaj zone zgjedhore. Në kërkesën ankimore është pretenduar se rreth 560 zgjedhës janë penguar të votojnë, për shkak të skadencës së dokumenteve; figurojnë 311 zgjedhës të shtuar në Himarë nga muaji prill 2023 deri në muajin qershor 2024, ndërsa nga dita e dekretimit të zgjedhjeve deri në mbylljen e fushatës janë përlllogaritur rreth 93 zgjedhës të tjerë që janë zhvendosur nga bashki të tjera në drejtim të Himarës me “letra” për të votuar; të paktën 1438 zgjedhës rezultojnë se kanë pasur probleme duke u identifikuar gabimisht, pra 17% e totalit të votuesve, numër ky tepër i lartë krahasuar me shifrën e 8.500 votuesve në total në këtë bashki në datën 4 gusht; nga të dhënat figurojnë 388 zgjedhës me verifikim pa shenja të gishtit, etj. Pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën ankimore, me vendimin nr. 19, datë 26.08.2024, KAS-i ka vendosur rrëzimin e saj dhe lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së të qarkut të Vlorës.

5. Në datën 30.08.2024 si koalicioni “Bashkë fitojmë”, ashtu edhe PBDNJ-ja kanë paraqitur padi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor (KZGJ), me objekt kundërshtimin e vendimit të KAS-it, konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit (36) të zonës zgjedhore Bashkia e Himarës, si dhe rregullimin e pasojave duke shpallur përsëritjen e zgjedhjeve në atë zonë. KZGJ-ja, bazuar në nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, duke vlerësuar se të dyja paditë lidhen midis tyre për nga objekti dhe shkak ligjor, si dhe i drejtohen së njëjtës palë në cilësinë e palës së paditur, ka vendosur kryesisht bashkimin e tyre, duke i shqyrtuar në një gjykim të vetëm. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 5, datë 09.09.2024, KZGJ-ja ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Sipas atij kolegji, jo çdo shkelje e procesit zgjedhor, qoftë kjo e lidhur edhe me cenimin e parimeve që qëndrojnë në themel të këtij procesi, përbën shkak absolut për të konkluduar për pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e shpalljes së pavlefshme të zgjedhjeve si një përjashtim nga rregulli, vetëm në ato raste kur konstatohet një shkelje që cenon rëndë integritetin e procesit zgjedhor, në

një nivel të tillë që krijon baza të arsyeshme për të vlerësuar se rezultati nuk i përgjigjet vullnetit të zgjedhësve.

6. Sipas KZGJ-së, në çdo rast të vlerësimit të parregullsive në zgjedhje, për të konkluduar në lidhje me pasojën e pavlefshmërisë që ka si shkak këto parregullsi, merret në konsideratë kriteri i shkallës së cenimit që sjellin këto parregullsi në procesin zgjedhor, ndërkohë që shkelje të rënda të procesit zgjedhor vlerësohen ato që ose i pengojnë, largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Po sipas atij kolegji, nuk mjafton të provohet se janë kryer shkelje që kanë cenuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provohet se “këto shkelje janë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”. KZGJ-ja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është vërtetuar se shkeljet ishin të tilla që të kushtëzonin rezultatin e zgjedhjeve dhe se pretendimet për procesin e votimit janë të përgjithshme, të mbështetura në fakte të paprovuara.

7. Në datën 16.06.2025, PBDNJ-ja (*kërkuesja*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit të saj, e cila, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.06.2025.

8. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuases

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se janë cenuar:

9.1. *E drejta për të zgjedhur*, e parashikuar nga neni 45 i Kushtetutës dhe neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në aspektin e së drejtës për të shprehur opinionin politik, pëlqyeshmërinë për një kandidat të caktuar në zgjedhjet vendore për kryetar bashkie, lirisht pa kufizime të paarsyeshme, për shkaqet e mëposhtme:

9.1.1. Nga shqyrtimi administrativ ka rezultuar se lista përfundimtare e zgjedhësve është emetuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në datën 10.07.2024, por nuk ka qenë publikuar tek e-Albania për konsultim për zgjedhësit deri në datën 26.07.2024. Nga provat e shqyrtuara në KAS dhe KZGJ ka rezultuar se 6210

zgjedhës kanë pasur letërnjoftim jashtë afatit të përdorimit. Duke pasur parasysh këtë numër dhe periudhën nga data e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ajo ka qenë e pamjaftueshme për zgjedhësit për të aplikuar dhe tërhequr letërnjoftimet e reja. Sipas të dhënave të KQZ-së, 99% e zgjedhësve nuk kanë pasaportë shqiptare brenda afatit të përdorimit, kurse sipas materialeve zgjedhore të qendrave të votimit (Libri i protokollit të mbledhjeve), në të gjitha qendrat ka pasur shtetas që janë paraqitur për të votuar, janë verifikuar në pajisjen elektronike, por nuk janë lejuar të votojnë për shkak të mbarimit të afatit të përdorimit të letërnjoftimeve apo që nuk janë identifikuar në pajisjen elektronike, por janë lejuar të votojnë nëpërmjet letërnjoftimeve brenda afatit të përdorimit.

- 9.1.2. Sipas KAS-it dhe KZGJ-së, zgjedhësit me letërnjoftime ose pasaporta që u kishte mbaruar afati i vlefshmërisë nuk mund të lejoheshin të votonin sipas nenit 105 të KZ-së, ndaj me të drejtë komisionet e qendrave të votimit nuk i kanë lejuar dhe numri i zgjedhësve që nuk u lejuan efektivisht të votojnë është më i vogël se diferenca ndërmjet kandidatëve. Ky arsyetim nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe interpretimi e zbatimi i dispozitave të KZ-së është i gabuar. Sipas nenit 105, shkronjat “a” dhe “c”, të KZ-së, elementet për t’u verifikuar nga komisioni i qendrës së votimit nuk kanë të bëjnë me afatin e përdorimit të letërnjoftimit ose pasaportës, të cilat kanë të dhëna biometrike, por vetëm me të dhënat e zgjedhësit, si dhe fotografinë. Edhe referuar nenit 5/1 të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë” (*ligji nr. 8952/2002*), kalimi i afatit nuk përcaktohet si rast pavlefshmërie i letërnjoftimit, pasi të dhënat daktiloskopike që mban letërnjoftimi nuk kanë afat skadence ose vlefshmërie. Në nenet 9/1, 9/2, 9/3 dhe 9/4 të këtij ligji është parashikuar zgjatja e vlefshmërisë së letërnjoftimeve dhe lejimi i përdorimit të tyre dhe për çdo zgjedhje afati i tyre është zgjatur me akt normativ të miratuar më pas në Kuvend, çka provon se afati i përdorimit nuk ka asnjë rol për procesin e identifikimit të shtetasve. Neni 105 i KZ-së nuk e lidh identifikimin e zgjedhësve me afatin e përdorimit të letërnjoftimit, por me të dhënat e gjendjes civile dhe fotografinë.
- 9.1.3. Fakti që ka mospërputhje ndërmjet numrit të votuesve që janë identifikuar elektronikisht, por kanë pasur letërnjoftime jashtë afatit të përdorimit, me ata që

janë penguar të votojnë me vendim të komisionit të qendrës së votimit, sipas procesverbaleve përkatëse, provon që KQZ-ja nuk është e aftë të llogarisë sa ka qenë numri real i shtetasve të cilët kanë shprehur vullnetin për të votuar, duke u paraqitur në qendrat e votimit dhe janë penguar, pasi pengimi për të votuar nuk është i pasqyruar në akte. Procesi zgjedhor i datës 04.08.2024 për kryetar të Bashkisë së Himarës është i pavlefshëm, pasi janë penguar të ushtrojnë të drejtën e votës 6157 banorë (zgjedhës).

9.1.4. Kufizimi i së drejtës së votës është bërë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës. Sipas nenit 105 të KZ-së dhe ligjit nr. 8952/2002, afati i përdorimit të letërnjoftimeve nuk cenon vlefshmërinë e tyre, ndaj mënyra e interpretimit të tyre nga KZGJ-ja është e gabuar, formaliste, duke e shkëputur nga qëllimi i parashikimit ligjor. Edhe në kuptim të Konventës dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit nuk mund të konsiderohet si “pengesë” e parashikuar qartësisht në ligj. Për rrjedhojë, ndërhyrja nuk plotëson as kriterin e “ligjshmërisë”. Po kështu, nuk ka asnjë interes publik në pengimin për të ushtruar të drejtën e votës të shtetasve që nuk kanë rinovuar letërnjoftimet, pasi afati i përdorimit të letërnjoftimit nuk pengon identifikimin e zgjedhësit dhe as ushtrimin e opinionit të tyre. Të njëjtët zgjedhës u lejuan të votojnë në zgjedhjet e datës 14.05.2023, megjithëse kishin letërnjoftime jashtë afatit të përdorimit. Po kështu, nuk respektohet as parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes, pasi mjete i përdorur nuk ishte proporcional me qëllimin që synohej të arrihej. Identifikimi i zgjedhësve mund të kryhej edhe në mënyra të tjera, pa u hequr atyre të drejtën për të votuar. Afati i përdorimit të letërnjoftimeve nuk cenon vlerën e tyre si mjete identifikimi, për sa kohë që të dhënat e këtyre dokumenteve kanë lidhje me gjurmët daktiloskopike të mbajtësit, të cilat nuk varen nga ky afat.

9.2. *Parimi i barazisë së shtetasve përpara ligjit*, pasi edhe pse ky proces zgjedhor ishte përsëritje e atij të datës 14.05.2023, ku me akt normativ u lejuan të votonin zgjedhës me letërnjoftime jashtë afatit të përdorimit, organet shtetërore nuk lejuan përdorimin e letërnjoftimeve me afat të përfunduar, ndonëse kishte rezultuar një numër i madh zgjedhësish që nuk kishin mjet identifikimi “të vlefshëm” dhe afati për përsëritjen e

letërnjoftimeve nga data kur u caktua data e zgjedhjeve deri në datën e zhvillimit të tyre e bënte të pamundur realizimin e këtij procesi. Trajtimi i ndryshëm i zgjedhësve në zgjedhjet e datës 04.08.2024 nuk është kryer për arsye objektive.

9.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, pasi:*

9.3.1. KZGJ-ja nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuases dhe arsytimi i saj është tërësisht formalist. Vendimi është bazuar vetëm në nenin 105 të KZ-së, ndërkohë që kërkuësja ka argumentuar se në këtë rast gjejnë zbatim edhe dispozitat për identifikimin elektronik të zgjedhësve. Kjo mënyrë identifikimi është vendosur nga Komisioni Rregullator me akt administrativ, i cili ishte në fuqi, ndaj KQZ-ja ka qenë e detyruar të instruktonte komisionet e qendrave të votimit të zbatonin këtë vendim, duke kryer identifikimin e shtetasve nëpërmjet pajisjeve elektronike. KZGJ-ja nuk ka arsyetuar në lidhje me këtë pretendim dhe as për atë se afati i përdorimit të letërnjoftimeve nuk është rast pavlefshmërie sipas ligjit.

9.3.2. Arsytimi i KZGJ-së se zgjedhësit që janë penguar të votojnë me vendim të komisioneve të qendrave të votimit janë 169, kurse diferenca e kandidatëve është 1477, ndaj bazuar në nenin 161 të KZ-së nuk është rasti për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, nuk mbështetet në provat e administruara. Organi administrativ që administron zgjedhjet, i cili ka barrën e provës, nuk është në gjendje të përcaktojë numrin e zgjedhësve të paraqitur në qendrat e votimit, por që nuk janë lejuar të votojnë për shkak të letërnjoftimit tej afatit të përdorimit. Procesverbalet e qendrave të votimit pasqyrojnë vetëm shtetasit e penguar të votojnë me vendim të këtyre komisioneve, ndërkohë që kanë qenë 256 shtetas të identifikuar nga pajisja PEI, pra që kanë filluar procesin e identifikimit, por nuk ka asnjë numër të zgjedhësve që janë paraqitur, por nuk kanë filluar procesin e identifikimit. KZGJ-ja nuk është shprehur për pretendimin e kërkuases se KQZ-ja nuk ka zbatuar aktet normative për identifikimin e zgjedhësve me pajisje elektronike. Arsytimi për zbatimin e nenit 105 të KZ-së, referuar rezervës së nenit 68, pika 2, të Kushtetutës, është antikushtetues dhe formal, pasi dispozita kushtetuese nuk i ka dhënë të drejtë ligjvënësit që të përcaktojë në kod kufizime të tjera në të drejtën për të votuar, por që të përcaktojë rregullat për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore etj. Përveç kësaj, neni 68 i Kushtetutës

ka të bëjë me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. KZGJ-ja ka pranuar se lista përfundimtare e zgjedhësve është shtuar me 311 votues në mënyrë të paligjshme, të cilët janë përafërsisht sa diferenca ndërmjet pjesëmarrësve në zgjedhjet e mëparshme të vitit 2023. Ajo është ndalur vetëm te diferenca ndërmjet numrit të zgjedhësve që janë penguar për të votuar me votim të komisionit të qendrës së votimit dhe diferencës ndërmjet kandidatëve, pa analizuar nëse shkeljet e tjera të identifikuar dhe të pranuar kanë ndikuar ose jo në rezultatin përfundimtar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

10. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, i cili përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese. Ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se koncepti “mosmarrëveshje kushtetuese” në nenin 124 të Kushtetutës e merr përmbajtjen e tij dhe përfshin çështjet kushtetuese që janë të parashikuara jo vetëm nga neni 131 i Kushtetutës, por edhe nga çdo dispozitë tjetër kushtetuese, mbi bazën e të cilave Gjykata ushtron kompetencat e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata, në funksion të kompetencës së parashikuar nga shkronja “e” e pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, sipas të cilës ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre, është ndalur në interpretimin e koncepteve që mbart kjo dispozitë, me qëllim përcaktimin nëse kontrolli i kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor të funksionarëve vendorë përfshihet në juridiksionin kushtetues. Në mbështetje të metodave të interpretimit literal, sistematik, qëllimor dhe historik, dhe duke i analizuar dispozitat kushtetuese në mënyrë integrale dhe harmonike, Gjykata ka vlerësuar se kushtetutëbërësi, duke mos e parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetencën për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor, ka pasur si qëllim të mos përfshijë në

juridiksionin kushtetues kontrollin e procedurave zgjedhore në tërësinë e tyre. Për këtë arsye, togfjalëshi “verifikimin e zgjedhjes së tyre” në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës duhet të interpretohet në kuptimin që ai ka të bëjë me verifikimin e respektimit të së drejtës individuale për t’u zgjedhur të funksionarit të organit kushtetues gjatë procesit zgjedhor. Kushtetutëbërësi nuk ka pasur qëllim t’i japë asaj kompetencën për të vlerësuar kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor në tërësinë e tij, ndaj dhe modalitetet e këtij procesi, si subjektet që e vënë në lëvizje Gjykatën, afatet, procedurat dhe lloji i vendimmarrjes për këtë lloj kontrolli, nuk gjenden as në ligjin organik, as në Kodin Zgjedhor (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në interpretimin e nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, si më lart, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se kërkimi për konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore mbetet jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj ajo nuk mund të vihet të lëvizje në lidhje me këtë çështje (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji, në këndvështrim të sa më sipër, duke iu referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve të KAS-it dhe KZGJ-së, të cilat kanë rrëzuar ankimet e saj për kundërshtimin e procesit zgjedhor të zhvilluar në Bashkinë e Himarës në datën 04.08.2024, për zgjedhjen e kryetarit të asaj bashkie. Për rrjedhojë, kërkuesja ka kundërshtuar edhe rezultatin e këtyre zgjedhjeve, duke kërkuar edhe konstatimin e pavlefshmërisë së tyre. Si bazë ligjore të kërkesës janë përcaktuar shkronjat “a”, “c” dhe “f” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë kompetencën e Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjeve dhe akteve normative me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e ankimeve kushtetuese individuale.

14. Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 7, datë 01.03.2022; nr. 22, datë 11.04.2016; nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, bazuar në shkaqet dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesja, në thelb, ka kërkuar verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor të zhvilluar në datën 04.08.2024 për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë së Himarës, me pretendimin se ai proces nuk ka respektuar të drejtën e zgjedhësve për të zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Edhe pse kërkuesja ka kundërshtuar përpara Gjykatës procesin administrativ dhe gjyqësor të zhvilluar mbi ankimin e subjektit zgjedhor që ka marrë pjesë në

zgjedhje, në thelb të kërkimeve të saj qëndron respektimi i parimeve dhe të drejtave kushtetuese gjatë vetë atij procesi zgjedhor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për sa kohë që thelbi i kërkimeve të kërkueses është konstatimi antikushtetues i zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor për zgjedhjen e organit të qeverisjes vendore, kryetarit të Bashkisë së Himarës, kjo çështje mbetet jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.